

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit R. R. nga fshati R., Komuna Lipjan, të cilën e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.3402/2016 të dt.05.05.2017, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1, pika 1.4 të KPRK-së, në shqyrtim gjyqësor publik, të mbajtur me dt.27.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit B. I., dhe të akuzuarit, me dt.27.04.2018 merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

R. R., i biri i Rr. dhe H. e gjinisë S., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin R. Komuna Lipjan, ku dhe banon, i martuar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, me profesion Bujk, me nr. personal *numri përsonal...*, me nr. *numri i telefonit...*, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse :

Me dt. 15.06.2016, rreth orës 11:00, në fshatin “R.”, në Lipjan, pas një mosmarrëveshje verbale që kishte pasur i dëmtuari J. Z. me djalin e vëllait të pandehurit, A. R. rreth shfrytëzimit të pronës shoqërore për kulloso, i pandehuri kishte shkuar pranë të dëmtuarit J. dhe me një shkop e kishte goditur në kokë të njejtin, me ç’rast i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme të shëndetit,-

-me këtë ka kryer vepër penale Lëndim i lehtë trupor neni 188 par.2 lidhur me par.1, pika 1.4 të KPRK-së

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 21, 41, 42, 43, 46, dhe nenit 188 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 200.-€, (dyqindëeuro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin e caktuar, konform nenit 46 të KPRK-së dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ku do të llogaritet shuma prej 20 €.- për një ditë burgimi.

I Dëmtuari- J. Z. nga fshat R., me nr. personal. *numri përsonal...*, me nr. tel. *numri i telefonit...*

DETYROHET e akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i’a paguajë shumën prej 20.-€, dhe shumen prej 30.-€ në Fondin e viktimave të krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.3402/2016 të dt.05.05.2017 e ka akuzuar të pandehurin R. R. nga fshati R., K.Lipjan, për shkak të veprës penale Lendim i lehtë trupor neni 188 par.2 lidhur me par.1, pika 1.4 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse një pranim i tillë është i mbështetur në provat që i përmban akti akuzues dhe i propozon gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e ndin vetin fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se ditën kritike ka qenë i provokuar nga i dëmtuari mirpo me të dëmtuarin tani jemi pajtuar dhe nuk kemi te keqe azgjë dhe i premtom gjykates që në të ardhmen nuk do të përsëritet ma, i ka propozuar gjykatës qe të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi që bindet se i pandehuri e ka kuptur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPPRK-së, se gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Lendim i lehtë trupor neni 188 par.2 lidhur me par.1, pika 1.4 të KPRK-së

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, faktin se i pandehuri për herë të parë bie ndesh me ligjin, sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme, e veçanarishtë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave renduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoj dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të bëjë kompenzimin e palës së dëmtuar si dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.1 dhe 2 nën par. 6 të KPRK-së ndersa vendimi për kompenzimin viktimave te krimin u bazua ne nenin 39 të Ligjit për mbrojtjen e viktimave te krimin.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIHTINË DEGA NË LIPJAN.

P.nr.391/2017 me dt.27.04.2018.

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate